ASCAP

ASCAP
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

MODUL KURRIKULAR

Kurrikula në Bazë Shkolle në Arsimin e Mesëm të Ulët

"FUQIA E RRËFIMIT"

Koordinator: Erida Koleci, Ludmilla Stefani

www.ascap.edu.al

2026

MODUL KURRIKULAR

KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT

"FUQIA E RRËFIMIT"

1. HYRJE

Rrëfimi (storytelling) është pjesë e përvojës njerëzore dhe një mënyrë interesante për të ndarë ngjarje, përvoja dhe ide. Që në moshë të vogël, njerëzit kanë rrëfyer për të shpjeguar atë që përjetojnë, për të ndarë kujtime dhe për të komunikuar me të tjerët. Kur një histori tregohet, dëgjuesit përqendrojnë vëmendjen, përfshihen në rrjedhën e ngjarjeve dhe krijojnë një lidhje me rrëfimtarin. Në këtë mënyrë, rrëfimi shërben jo vetëm për të përcjellë informacion dhe për kënaqësi estetike, por edhe për të ndërtuar marrëdhënie dhe për të krijuar përjetime të përbashkëta.

Në kontekstin shkollor, rrëfimi është një mjet i rëndësishëm për të nxënë dhe për t'u shprehur. Përmes rrëfimeve, nxënësit mësojnë të organizojnë mendimin, të shprehin ndjenja dhe ide, si dhe të kuptojnë përvojat e tyre dhe të të tjerëve. Rrëfimi i ndihmon ata të zhvillojnë aftësinë për të parë situatat nga këndvështrime të ndryshme, për të ndërtuar kuptime më të thella dhe për të komunikuar në mënyrë më të qartë dhe më të strukturuar. Gjithashtu, rrëfimi i ndihmon nxënësit të organizojnë idetë në mënyrë logjike, duke i lidhur ato në një rrjedhë të qartë ngjarjesh. Ata mësojnë të dallojnë elementet kryesore të një rrëfimi, si personazhet, vendin dhe kohën, konfliktin dhe zgjidhjen, si dhe mesazhin që përcillet. Kjo i ndihmon jo vetëm në krijimin e historive, por edhe në kuptimin më të mirë të teksteve që lexojnë.

Megjithëse të gjithë mund të rrëfejnë, aftësia për të ndërtuar rrëfime të qarta, të strukturuara dhe shprehëse zhvillohet përmes udhëzimit dhe praktikës. Në këtë kuadër, ky modul synon të mbështesë mësuesit në zhvillimin e kësaj aftësie te nxënësit, duke ofruar modele rrëfimesh, mundësi për praktikë dhe reflektim, si dhe udhëzime për hartimin dhe prezantimin e rrëfimeve.

2. QËLLIMET E MODULIT "FUQIA E RRËFIMIT"

Ky modul është hartuar në përputhje me ligjin nr. 69/2012 "*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili përcakton organizimin dhe funksionimin e sistemit arsimor, si dhe strukturën e kurrikulës në arsimin parauniversitar. Sipas këtij ligji, shkollat e arsimit bazë kanë mundësinë të hartojnë ose të zbatojnë module në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, në përputhje me nevojat dhe me interesat e nxënësve.

Moduli mbështetet gjithashtu në Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë, e cila vendos në qendër zhvillimin e kompetencave kyç, si dhe në planin mësimor të arsimit bazë, i cili parashikon hapësirë për zhvillimin e kurrikulës në bazë

shkolle. Në këtë kontekst, moduli “Fuqia e rrëfimit” kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencës së komunikimit, si dhe të kompetencave qytetare dhe personale.

Ky modul pasuron programet lëndore të fushës “Gjuhët dhe komunikimi”, duke u përqendruar në zhvillimin praktik të aftësive të rrëfimit në situata të ndryshme komunikimi. Ai u përgjigjet synimeve të kurrikulës në bazë shkolle, e cila synon:

- plotësimin e nevojave dhe interesave të nxënësve;
- zhvillimin e aftësive psiko-sociale;
- përgatitjen për jetën dhe orientimin e hershëm;
- përforcimin e njohurive dhe të aftësive të fituara në lëndët mësimore.

Rëndësia e këtij moduli në arsimin bazë është e veçantë, pasi kjo fazë përkon me zhvillimin e identitetit të nxënësit dhe me formimin e aftësive bazë të komunikimit. Në këtë nivel, nxënësit përballen me situata të ndryshme ku rrëfimi luan rol të rëndësishëm. Rrëfimi nuk është vetëm një aftësi gjuhësore, por një formë komunikimi përmes së cilës organizohen dhe tregohen ngjarje, përvoja ose ide në një rend logjik dhe kuptimplotë, me qëllim për të informuar, për të ndikuar ose për të përfshirë dëgjuesin. Ky proces përfshin:

- përzgjedhjen dhe organizimin logjik të ideve;
- ndërtimin e një strukture të qartë narrative/rrëfyese (fillim, zhvillim, mbyllje);
- zhvillimin e personazheve, ngjarjeve dhe lidhjeve midis tyre;
- përshtatjen e rrëfimit me audiencën dhe me qëllimin e komunikimit;
- përdorimin e një gjuhe të qartë, të pasur dhe shprehëse;
- përdorimin e elementeve joverbale dhe mjeteve mbështetëse për të përforcuar mesazhin;
- shprehjen e emocioneve dhe përfshirjen e dëgjuesit.

Zhvillimi i aftësisë për të rrëfyer ndikon drejtpërdrejt:

- në rritjen e vetëbesimit dhe të sigurisë në të shprehur;
- në zhvillimin e mendimit krijues dhe kritik;
- në përmirësimin e komunikimit ndërpersonal;
- në rritjen e aftësisë për të kuptuar dhe për të interpretuar përvoja;
- në formimin e identitetit të nxënësit..

Qëllimet i këtij moduli janë që nxënësit:

- të kuptojnë dhe të vlerësojnë rëndësinë e rrëfimit në jetën personale dhe shoqërore;
- të zhvillojnë aftësi për të krijuar dhe prezantuar rrëfime të qarta, të strukturuara dhe shprehëse;
- të aftësohen si rrëfimtarë dhe dëgjues aktivë dhe etikë;
- të përdorin forma të ndryshme të rrëfimit në varësi të qëllimit dhe të audiencës;

- të fitojnë vetëbesim në shprehjen e ideve, ndjenjave dhe përvojave të tyre.

Në përfundim të modulit, nxënësit pritet të demonstrojnë aftësi për të krijuar dhe për të prezantuar rrëfime në mënyrë të kuptueshme, të strukturuar dhe krijuese, duke e përdorur gjuhën në mënyrë të përshtatshme dhe shprehëse.

3. PËRMBAJTJA E MODULIT

Ky modul përqendrohet te rrëfimi si një formë e rëndësishme komunikimi dhe si një mjet për të shprehur përvoja, për të ndërtuar kuptim dhe për të krijuar lidhje me të tjerët. Në këtë kuadër, nxënësit njihen me konceptin e rrëfimit, duke kuptuar çfarë është një rrëfim dhe pse njerëzit ndajnë përvojat e tyre, si në traditën gojore, ashtu edhe në format moderne të komunikimit.

Në vijim, nxënësit punojnë me elementet përbërëse të një rrëfimi, duke analizuar strukturën e rrëfimit, rolin e personazheve, vendin dhe kohën e ngjarjeve, si dhe konfliktin, zgjidhjen dhe mesazhin që përcillet. Kjo shoqërohet me zhvillimin e gjuhës dhe stilit të rrëfimit, ku theksi vendoset te përdorimi i vetës së duhur, pasurimi i fjalorit, përdorimi i dialogut dhe i përshkrimeve, si dhe te ndërtimi i një zëri personal dhe emocional.

Moduli trajton gjithashtu teknika të rrëfimit efektiv, të cilat ndihmojnë nxënësit të ndërtojnë rrëfime tërheqëse dhe kuptimplota, duke përdorur fillime që tërheqin vëmendjen, renditje të qartë të ngjarjeve, ndërtim të tensionit dhe përdorim të detajeve konkrete.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të dëgjimit aktiv dhe empatisë, duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë dhe të respektojnë rrëfimet e të tjerëve, si dhe të ndërveprojnë në mënyrë të ndjeshme dhe të përgjegjshme gjatë ndarjes së rrëfimeve.

Në një qasje bashkëkohore, moduli përfshin edhe njohjen me forma të ndryshme të rrëfimit, si rrëfimi me shkrim dhe ai gojor, si dhe format digjitale, si podcast, vlog dhe tregim digjital, duke i inkurajuar nxënësit të përdorin mjete të ndryshme për të shprehur rrëfimet e tyre.

Përmes leximit dhe analizës së rrëfimeve ose tregimeve të autorëve të ndryshëm, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të kuptuar stile të ndryshme rrëfimi dhe për të reflektuar mbi përvojat e tyre dhe të të tjerëve.

Në përmbyllje, nxënësit angazhohen në krijimin dhe prezantimin e një rrëfimi personal, duke përdorur forma të ndryshme shprehjeje, përfshirë edhe elemente vizuale dhe digjitale. Ky proces shoqërohet me reflektim dhe vetëvlerësim, duke i ndihmuar ata të ndërgjegjësohen për zhvillimin e aftësive të tyre dhe për rolin e rrëfimit në komunikim.

Ky modul organizohet në disa tematika, të cilat janë:

- Rrëfimi dhe rëndësia e tij
- Struktura dhe elementet e rrëfimit

- Gjuha dhe stili i rrëfimit
- Teknika të rrëfimit
- Rrëfimi dhe teknologjia digjitale
- Dëgjimi aktiv dhe empatia në rrëfim
- Krijimi dhe prezantimi i rrëfimeve

Rrëfimi dhe rëndësia e tij

Në këtë tematikë, nxënësit njihen me rrëfimin si një formë të rëndësishme komunikimi përmes së cilës tregohen ngjarje, përvoja ose ide në mënyrë të kuptueshme dhe domethënëse. Ata kuptojnë se rrëfimi nuk shërben vetëm për të argëtuar, por edhe për të informuar, për të shprehur ndjenja dhe për të ndërtuar lidhje me të tjerët.

Duke u nisur nga përvoja të përditshme, si tregimi i një ngjarjeje personale apo i një kujtimi, nxënësit reflektojnë mbi arsyet pse njerëzit tregojnë histori. Ata kuptojnë se rrëfimi ndihmon për të kuptuar botën dhe për të ndarë përvoja, duke ndikuar jo vetëm në mendim, por edhe në emocion. Në vijim, trajtohet roli i rrëfimit në kulturë dhe komunikim. Nxënësit njihen me forma të ndryshme të rrëfimit në traditën gojore, si përralla, legjenda, mite, fabula dhe këngë popullore, duke kuptuar se këto rrëfime kanë ndihmuar në ruajtjen e traditave, vlerave dhe kujtesës kolektive. Krahas kësaj, nxënësit njihen edhe me rrëfimin në letërsinë e shkruar, përmes teksteve si tregime, novela, romane, kujtime, ditarë, biografi, autobiografi dhe ese. Ata analizojnë mënyrën si autorët ndërtojnë ngjarjet, personazhet dhe mesazhin, si dhe dallojnë forma të ndryshme të rrëfimit, si rrëfimi realist apo imagjinar, rrëfimi në vetën e parë ose të tretë. Në një qasje bashkëkohore, kjo temë përfshin edhe format moderne të rrëfimit, si rrëfimet në media dhe në mjedise digjitale (video, blogje, rrjete sociale), duke i ndihmuar nxënësit të kuptojnë se rrëfimi vazhdon të zhvillohet dhe të përshtatet me mënyrat e reja të komunikimit.

Në këtë mënyrë, nxënësit ndërtojnë një kuptim të plotë të rrëfimit si mjet komunikimi dhe shprehjeje, duke vendosur bazat për zhvillimin e aftësive të tyre në krijimin dhe paraqitjen e historive.

Rrëfimi *është arti i përdorimit të fjalëve, veprimeve, figurave dhe mjeteve të ndryshme shprehëse për të treguar histori dhe për të përcjellë mesazhe, emocione dhe vlera te audienca. Ai përbën një formë themelore komunikimi, e cila përdoret për të informuar, për të edukuar, për të argëtuar dhe për të ruajtur kulturën dhe përvojat njerëzore. Rrëfimi mund të realizohet në forma të ndryshme, si rrëfimi gojor, i shkruar, vizual ose digjital, duke e bërë informacionin më të kuptueshëm, më tërheqës dhe më të lehtë për t'u kujtuar.*

Struktura dhe elementet e rrëfimit

Në këtë temë, nxënësit njihen me mënyrën si ndërtohet një rrëfim i qartë dhe kuptimplotë, duke kuptuar lidhjen midis strukturës dhe elementeve përbërëse të tij. Ata mësojnë se çdo histori ka një organizim të brendshëm që e bën atë të kuptueshme dhe interesante për dëgjuesin ose lexuesin.

Fillimisht, nxënësit punojnë me strukturën bazë të rrëfimit, e cila përfshin: fillimin (prezantimi i situatës dhe personazheve), zhvillimin (rrjedha e ngjarjeve dhe ndërtimi i konfliktit) dhe përfundimin (zgjidhja dhe mbyllja e historisë). Ata kuptojnë se kjo strukturë ndihmon në organizimin logjik të ideve dhe në ndjekjen e rrjedhës së ngjarjeve.

Në vijim, trajtohen elementet kryesore të rrëfimit, si:

- personazhet (kush janë dhe çfarë roli kanë);
- vendi dhe koha (ku dhe kur ndodhin ngjarjet);
- ngjarjet (çfarë ndodh dhe si lidhen ato mes tyre);
- konflikti (problemi ose sfida që nxit rrëfimin);
- zgjidhja (si përfundon historia);
- mesazhi (çfarë kuptimi ose mësimi përcillet).



Nxënësit mësojnë të dallojnë dhe të përdorin këto elemente për të ndërtuar rrëfime më të qarta dhe më të strukturuara. Ata kuptojnë gjithashtu se jo çdo rrëfim ndjek gjithmonë të njëjtin rend: ngjarjet mund të tregohen në mënyrë kronologjike ose duke përdorur kthime pas në kohë (flashback), në varësi të qëllimit të tregimit.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të organizuar idetë në formë narrative dhe për të ndërtuar histori që kanë kuptim, rrjedhë dhe lidhje logjike midis pjesëve të tyre.

Gjuha dhe stili i rrëfimit

Në këtë temë, nxënësit njihen me mënyrën si përdoret gjuha për të ndërtuar një rrëfim të qartë, të kuptueshëm dhe tërheqës. Ata kuptojnë se mënyra si tregojmë një histori është po aq e rëndësishme sa vetë përmbajtja e saj.

Fillimisht, nxënësit punojnë me përdorimin e vetës së parë dhe të tretë në rrëfim, duke kuptuar ndryshimin mes tyre dhe efektin që krijojnë te dëgjuesi ose lexuesi. Ata mësojnë të përdorin kohën e foljeve (kryesisht kohën e shkuar) për të treguar ngjarje që kanë ndodhur, duke ruajtur qartësinë dhe vijueshmërinë e tregimit.

Në këtë kuadër, nxënësit njihen edhe me përdorimin e klasave të ndryshme të fjalëve në rrëfim:

- foljet, që tregojnë veprimin dhe zhvillimin e ngjarjeve (p.sh.: u nisa, pashë, mendova);
- emrat, që përcaktojnë personazhet, vendet dhe objektet (p.sh.: vajza, qyteti, shtëpia);
- mbiemrat, që pasurojnë përshkrimin (p.sh.: rrugë e errët, zë i dridhur);
- ndajfoljet, që tregojnë mënyrën, kohën dhe vendin (p.sh.: papritur, ngadalë, aty);
- lidhëzat, që sigurojnë lidhjen dhe vijueshmërinë e ideve (p.sh.: pastaj, më pas, sepse, por).

Në vijim, theksi vendoset te pasurimi i gjuhës, përmes përdorimit të fjalëve përshkruese që ndihmojnë në paraqitjen e personazheve, vendeve dhe situatave. Nxënësit ushtrohen në përdorimin e llojeve të ndryshme të fjalive (të thjeshta dhe të përbëra), përshkrimeve dhe dialogut për ta bërë rrëfimin më të gjallë dhe më realist.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet stilit të rrëfimit, ku nxënësit mësojnë të ndërtojnë një zë personal dhe të përdorin një ton të përshtatshëm në varësi të historisë që tregojnë. Ata kuptojnë rëndësinë e shprehjes së emocioneve dhe të përfshirjes së dëgjuesit, duke e bërë rrëfimin më të afërt dhe më domethënës.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të përdorur gjuhën në mënyrë të vetëdijshme dhe krijuese, duke ndërtuar rrëfime që janë të qarta, të pasura në shprehje dhe të përshtatshme për audiencën.

Teknika të rrëfimit

Në këtë temë, nxënësit njihen me teknikat që ndihmojnë në ndërtimin e një rrëfimi tërheqës dhe të kuptueshëm. Ata kuptojnë se mënyra si organizohet dhe paraqitet historia ndikon drejtpërdrejt në interesin dhe përfshirjen e dëgjuesit ose të lexuesit.

Fillimisht, nxënësit mësojnë teknika për fillimin e rrëfimit, si:

- nisja me një ngjarje të papritur (*Papritur, dera u hap me një zhurmë të fortë…*);
- nisja me një përshkrim ose atmosferë (*Ishte një mëngjes i ftohtë dimri dhe rruga ishte bosh…);*

- nisja me një pyetje ose mendim që ngjall kureshtje *(A ju ka ndodhur ndonjëherë të humbisni rrugën?).*

Në vijim, ata punojnë me organizimin e rrëfimit, duke përdorur:

- rendin kronologjik të ngjarjeve;
- kthimin pas në kohë (flashback), për të shpjeguar ngjarje të mëparshme;
- përqendrimin te momentet kyç të historisë (kulmi dhe zgjidhja).

Një element i rëndësishëm është ndërtimi i interesit dhe i tensionit në rrëfim. Nxënësit mësojnë të zhvillojnë ngjarjet në mënyrë graduale, duke krijuar pritje dhe duke e mbajtur vëmendjen e dëgjuesit.

Gjithashtu, ata ushtrohen në përdorimin e teknikave konkrete të rrëfimit, si:

- përdorimi i detajeve konkrete në vend të përgjithësimeve;
- përdorimi i dialogut për të gjallëruar historinë;
- përdorimi i përshkrimeve për të krijuar atmosferë;
- përzgjedhja e detajeve domethënëse nga përvoja personale.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të ndërtuar rrëfime më të strukturuara dhe më tërheqëse, duke përdorur teknika që e bëjnë historinë më të qartë, më të gjallë dhe më të lehtë për t'u ndjekur.

Rrëfimi dhe teknologjia digjitale

Në këtë temë, nxënësit njihen me mënyrën si teknologjia ndikon dhe pasuron rrëfimin, duke e bërë atë më të larmishëm dhe më tërheqës. Ata kuptojnë se rrëfimi nuk zhvillohet vetëm në formë gojore ose të shkruar, por edhe përmes mjeteve dhe platformave digjitale.

Fillimisht, nxënësit njihen me forma të ndryshme të rrëfimit digjital, si:

- video rrëfime (vlog);
- rrëfim audio (podcast);
- tregim digjital që kombinon tekstin, zërin dhe imazhin.

Në vijim, ata mësojnë si të përdorin mjete të thjeshta digjitale për të krijuar dhe për të paraqitur historitë e tyre, si aplikacione për prezantime, regjistrim audio ose video. Nxënësit kuptojnë rëndësinë e organizimit të përmbajtjes edhe në mjedise digjitale, duke shmangur mbingarkesën dhe duke u përqendruar te mesazhi kryesor.

Një vëmendje e veçantë i kushtohet përdorimit të teknologjisë në mënyrë të përgjegjshme dhe etike. Nxënësit mësojnë të respektojnë të drejtën e autorit, të mos kopjojnë përmbajtje dhe të përdorin burime të besueshme.

Gjithashtu, ata njihen me përdorimin e mjeteve digjitale për të përmirësuar rrëfimin, si:

- aplikacione për rregullimin e tekstit;
- mjete për regjistrimin dhe analizën e zërit;
- platforma që ndihmojnë në organizimin e ideve.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të përdorur teknologjinë si mjet mbështetës për rrëfimin, duke krijuar histori që janë të qarta, kreative dhe të përshtatshme për audienca të ndryshme.

Mjeti	Funksioni
Storyjumpe https://www.storyjumper.com/	**Storyjumper** është një platformë digjitale që mundëson krijimin e librave digjitalë me tekst, imazhe dhe elemente audio.
Book Creator https://www.bookcreator.com/	**Book Creator** është një platformë digjitale që mundëson krijimin e librave ndërveprues me tekst, audio, video dhe vizatime, duke u dhënë nxënësve mundësinë të ndërtojnë tregime multimediale dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre krijuese dhe digjitale.
Storybird https://www.storybird.com	**Storybird** është një platformë digjitale që u mundëson nxënësve të krijojnë tregime dhe poezi duke u bazuar në ilustrime artistike, duke nxitur imagjinatën, krijimtarinë dhe organizimin e tekstit narrativ.
Canva https://www.canva.com/	**Canva** është një platformë digjitale që mundëson krijimin e slajdeve, posterave dhe tregimeve vizuale, duke u përdorur për prezantimin e tregimeve dhe zhvillimin e teksteve narrative me elemente pamore.
Padlet https://www.padlet.com/	**Padlet** është një mur digjital ndërveprues që përdoret për stuhi mendimi, renditjen e ngjarjeve dhe zhvillimin e personazheve, duke mbështetur planifikimin e historisë, punën bashkëpunuese, si dhe zhvillimin e diskutimeve dhe reflektimeve në klasë.
Animaker	**Animaker** është një platformë digjitale që mundëson krijimin e videove të animuara me personazhe dhe dialogë, duke u përdorur për zhvillimin e dialogëve në gjuhë të huaj,

https://www.animaker.com/	realizimin e lojës me role digjitale dhe përmirësimin e aftësive të të folurit.

Në procesin e tregimit të historive personale, këto mjete digjitale shërbejnë për të mbështetur nxënësit në planifikimin e përmbajtjes, ndërtimin e strukturës narrative, pasurimin e historisë me elemente vizuale dhe zanore, si dhe në prezantimin e produkteve të tyre krijuese.

Shembull:

Faza I	**Faza II**	**Faza III**
Planifikimi	***Krijimi***	***Prezantimi***
- Stuhi mendimesh (brainstorming) në Padlet. - Përzgjedhja e temës, personazheve dhe mjedisit. - Hartimi i strukturës së historisë.	- Shkrimi i tekstit në Storybird, Storyjumper ose Book Creator. - Përgatitja e elementeve vizuale në Canva. - Regjistrimi i narracionit dhe i dialogëve.	- Prezantim i historive në klasë. - Shfaqje librash digjitalë ose videosh të animuara. - Diskutim dhe reflektim mbi përmbajtjen. - Bashkëpunim online.

Vlerësimi i produkteve narrative digjitale mund të përqendrohet në strukturën e historisë, korrektësinë gjuhësore, qartësinë e mesazhit, nivelin e kreativitetit dhe përdorimin funksional të mjeteve digjitale. Si instrumente vlerësimi rekomandohen përdorimi i rubrikave të vlerësimit, listave të kontrollit, si dhe vetëvlerësimi dhe vlerësimi mes nxënësve.

Gjatë zhvillimit të veprimtarive të rrëfimit digjital, mësuesi duhet t'u kujtojë nxënësve respektimin e të drejtave të autorit, mbrojtjen e të dhënave personale, përdorimin e platformave të sigurta për fëmijë dhe rëndësinë e publikimit të kontrolluar të produkteve të tyre.

Dëgjimi aktiv dhe empatia në rrëfim

Në këtë temë, nxënësit njihen me rolin e tyre jo vetëm si rrëfimtarë, por edhe si dëgjues. Ata kuptojnë se një rrëfim i mirë nuk varet vetëm nga mënyra si tregohet, por edhe nga mënyra si dëgjohet dhe kuptohet nga të tjerët.

Fillimisht, nxënësit mësojnë çfarë do të thotë dëgjim aktiv, duke u përqendruar te vëmendja ndaj rrëfimtarit, shmangia e ndërprerjeve dhe ndjekja e rrjedhës së historisë. Ata ushtrohen të tregojnë se po dëgjojnë përmes reagimeve të thjeshta, si:

- kontakti me sy;

- tundja e kokës;
- pyetje të shkurtra (*Çfarë ndodhi më pas?*).

Në vijim, theksi vendoset te empatia, pra aftësia për të kuptuar dhe për të respektuar ndjenjat dhe përvojat e të tjerëve. Nxënësit mësojnë të vendosin veten në vendin e tjetrit dhe të reagojnë në mënyrë të ndjeshme dhe të përshtatshme.

Ata njihen me mënyra konkrete për të reaguar gjatë dëgjimit të një rrëfimi:

- të bëjnë pyetje që ndihmojnë kuptimin (*Si u ndjeve në atë moment?*);
- të japin komente mbështetëse (*Më pëlqeu si e tregove këtë pjesë*);
- të shmangin gjykimet ose ndërprerjet e panevojshme.

Gjithashtu, nxënësit kuptojnë se çdo rrëfim është personal dhe kërkon respekt, veçanërisht kur lidhet me përvoja emocionale. Ata mësojnë të krijojnë një mjedis të sigurt dhe të hapur, ku secili ndihet i lirë të shprehet.

Në këtë mënyrë, nxënësit zhvillojnë aftësi të rëndësishme komunikimi, duke u bërë jo vetëm rrëfimtarë më të mirë, por edhe dëgjues më të vëmendshëm dhe më të ndjeshëm ndaj të tjerëve.

Krijimi dhe prezantimi i rrëfimeve (produkti final)

Në këtë pjesë përmbyllëse të modulit, nxënësit angazhohen në krijimin dhe prezantimin e një rrëfimi si produkt final, duke zbatuar njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë modulit. Kjo fazë synon të konkretizojë të nxënit.

Fillimisht, nxënësit përzgjedhin temën e rrëfimit, e cila mund të lidhet me një përvojë personale, një ngjarje të rëndësishme, një kujtim apo një situatë të imagjinuar. Ata planifikojnë rrëfimin duke përcaktuar strukturën, elementet kryesore dhe mesazhin që duan të përcjellin.

Në vijim, nxënësit hartojnë rrëfimin duke përdorur gjuhë të qartë dhe shprehëse, duke zbatuar teknikat e rrëfimit dhe duke organizuar idetë në mënyrë të strukturuar. Ata punojnë për përmirësimin e tekstit përmes rishikimit dhe sugjerimeve nga mësuesi dhe bashkëmoshatarët.

Në fazën e prezantimit, nxënësit paraqesin rrëfimet e tyre përpara klasës ose në një format digjital (video, audio, prezantim), duke përdorur elemente joverbale dhe mjete mbështetëse për ta bërë tregimin më tërheqës. Ata përshtatin mënyrën e të treguarit sipas audiencës dhe kontekstit.

Gjatë këtij procesi, nxënësit zhvillojnë edhe aftësinë për të dëgjuar dhe për të vlerësuar rrëfimet e të tjerëve, duke dhënë komente të qarta dhe mbështetëse. Në përfundim, ata reflektojnë mbi punën e tyre, mbi vështirësitë e hasura dhe mbi përparimin e bërë gjatë modulit.

Produkti final shërben si një dëshmi konkrete e zhvillimit të aftësisë së rrëfimit, duke treguar dhe prezantuar histori të qarta, të strukturuara dhe domethënëse.

4. KLASAT KU MUND TË ZHVILLOHET MODULI "FUQIA E RRËFIMIT"

Ky modul mund të zhvillohet në klasën VI ose VII ose VIII ose IX të arsimit të mesëm të ulët. Zbatimi i tij në secilën prej këtyre klasave është i përshtatshëm, pasi rrëfimi është një aftësi që zhvillohet gradualisht dhe lidhet ngushtë me komunikimin, mendimin kritik dhe krijimtarinë e nxënësve.

Në klasat VI ose VII, moduli mund të përqendrohet më shumë te ndërtimi i rrëfimeve të thjeshta, organizimi i ngjarjeve, përdorimi i gjuhës shprehëse dhe tregimi i përvojave personale. Në këtë fazë, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të strukturuar mendimet dhe për të komunikuar në mënyrë më të qartë dhe më të kuptueshme.

Në klasat VIII ose IX, moduli mund të trajtohet në mënyrë më të thelluar, duke përfshirë analiza më komplekse të rrëfimit, përdorimin e teknikave narrative, ndërtimin e mesazhit, krijimin e stilit personal dhe përdorimin e formave digjitale të tregimit. Në këtë nivel, nxënësit janë më të aftë të reflektojnë mbi përvojat dhe të ndërtojnë rrëfime më cilësore dhe më mbresëlënëse .

5. MËSUESIT QË MUND TË ZHVILLOJNË MODULIN "FUQIA E RRËFIMIT"

Moduli mund të zhvillohet nga:

- mësues të gjuhës shqipe;
- mësues të gjuhëve të huaja;
- mësues të arteve.

Mësuesit që zhvillojnë këtë modul:

- duhet të nxisin te nxënësit dëshirën për të treguar dhe për të ndarë përvoja, ide dhe rrëfime personale;
- duhet të krijojnë një mjedis të sigurt, të hapur dhe mbështetës, ku nxënësit të ndihen të lirë të shprehen dhe të dëgjojnë njëri-tjetrin me respekt;
- duhet të praktikojnë dhe të zhvillojnë dëgjimin aktiv, empatinë dhe komunikimin e ndjeshëm në klasë;
- duhet të zotërojnë njohuri bazë për strukturën, elementet dhe teknikat e rrëfimit;
- duhet të përdorin metoda dhe veprimtari krijuese që nxisin imagjinatën, krijimtarinë, reflektimin dhe bashkëpunimin;
- duhet të udhëzojnë nxënësit në përdorimin e gjuhës shprehëse;
- duhet të përdorin mjete dhe platforma digjitale për krijimin, ilustrimin dhe prezantimin e rrëfimeve.

6. KOHËZGJATJA E MODULIT "FUQIA E RRËFIMIT"

Moduli "Fuqia e rrëfimit" zhvillohet në 35 orë mësimore. Përmbajtja e modulit mbetet e njëjtë në të gjitha klasat e arsimit të mesëm të ulët, ndërsa ndryshon mënyra e trajtimit të saj, në varësi të moshës, nivelit dhe përvojës së nxënësve.

Gjithashtu, mësuesi ka mundësi të përshtatë numrin e orëve për secilën tematikë, llojin e veprimtarive dhe mënyrën e organizimit të punës, sipas nevojave dhe ritmit të të nxënit të nxënësve. Kjo i jep modulit fleksibilitet dhe mundëson zbatimin e tij në kontekste të ndryshme klasore.

Duke qenë se moduli zhvillohet në kuadër të kurrikulës në bazë shkolle, ai nuk vlerësohet me notë. Vlerësimi mbështetet kryesisht në pjesëmarrjen, angazhimin dhe përfshirjen e nxënësve në veprimtaritë e modulit, si dhe në realizimin e produktit final. Ai zhvillohet si vlerësim për të nxënë, përmes komenteve, sugjerimeve dhe reflektimit të vazhdueshëm nga mësuesi dhe nga bashkëmoshatarët.

7. REZULTATET E TË NXËNIT

Gjatë zhvillimit të modulit "Fuqia e rrëfimit", nxënësi:

- kupton rolin dhe rëndësinë e rrëfimit si formë komunikimi dhe si mjet për të ndarë përvoja, ide dhe emocione;
- dallon forma të ndryshme të rrëfimit në jetën e përditshme, letërsi, folklor dhe media digjitale;
- identifikon funksionet e rrëfimit në jetën personale, shoqërore dhe në shkollë;
- analizon elementet kryesore të një rrëfimi, si personazhet, vendi, koha, ngjarjet, konflikti dhe mesazhi;
- dallon strukturën e rrëfimit (fillimi, zhvillimi, kulmi, përfundimi) dhe shpjegon funksionin e secilës pjesë;
- organizon ngjarjet në mënyrë logjike dhe kronologjike;
- përdor forma të ndryshme të organizimit të rrëfimit, si rendi kronologjik dhe flashback-u;
- ndërton rrëfime të qarta dhe të kuptueshme duke respektuar strukturën narrative;
- përdor vetën e parë dhe të tretë në rrëfim sipas qëllimit të tregimit;
- përdor kohët e foljeve në mënyrë të përshtatshme gjatë rrëfimit të ngjarjeve;
- përdor emra, mbiemra, ndajfolje dhe folje për të pasuruar përshkrimin dhe për ta bërë tregimin më të gjallë dhe më shprehës;
- përdor fjali të thjeshta dhe të përbëra për të krijuar rrjedhë dhe lidhje logjike në rrëfim;
- përdor dialogun dhe përshkrimin për të zhvilluar personazhet dhe situatat;

- përdor gjuhë të qartë, të kuptueshme dhe shprehëse gjatë krijimit të rrëfimeve;
- shpreh emocione, ndjenja dhe përjetime përmes gjuhës dhe stilit të rrëfimit;
- zbaton teknika të ndryshme të rrëfimit për të tërhequr dhe mbajtur vëmendjen e dëgjuesit ose lexuesit;
- përshtat mënyrën e rrëfimit sipas audiencës dhe qëllimit të komunikimit;
- dëgjon në mënyrë aktive rrëfimet e të tjerëve;
- bën pyetje dhe komente që tregojnë vëmendje dhe interes ndaj rrëfimit;
- shpreh empati dhe respekt ndaj përvojave dhe këndvështrimeve të të tjerëve;
- bashkëpunon me të tjerët gjatë krijimit dhe zhvillimit të rrëfimeve;
- përdor mjete dhe platforma digjitale për krijimin dhe prezantimin e rrëfimeve;
- kombinon tekstin, figurën, zërin dhe elemente të tjera pamore në rrëfime digjitale;
- përdor teknologjinë në mënyrë të sigurt dhe etike gjatë krijimit të përmbajtjeve;
- krijon rrëfime personale, krijuese dhe imagjinare në forma të ndryshme;
- prezanton rrëfime me gojë ose në forma digjitale përpara një audience;
- përdor elemente joverbale dhe mjete mbështetëse gjatë prezantimit të rrëfimit;
- reflekton mbi procesin e krijimit dhe të prezantimit të rrëfimeve;
- identifikon pikat e forta dhe vështirësitë në rrëfimet e veta;
- vlerëson rrëfimet e veta dhe të të tjerëve përmes komenteve dhe sugjerimeve për përmirësim;
- përmirëson rrëfimet në bazë të reflektimit dhe të komenteve të mësuesit dhe të bashkëmoshatarëve.

8. VEPRIMTARI PRAKTIKE PËR ZHVILLIMIN E MODULIT "FUQIA E RRËFIMIT"

Më poshtë janë përshkruar disa veprimtari sugjeruese praktike, të cilat janë grupuar sipas tematikave të modulit. Mësuesit janë të lirë të përzgjedhin disa prej tyre, t'i përshtatin sipas nevojave të klasës ose të planifikojnë veprimtari të reja, në funksion të përmbushjes së rezultateve të pritshme të modulit.

TEMATIKA 1: RRËFIMI DHE RËNDËSIA E TIJ

1) *"Pse rrëfejmë?"*

Mësuesi paraqet situata dhe shembuj të ndryshëm rrëfimi nga jeta e përditshme dhe nga media, si: një kujtim familjar, një lajm, një video online, një përrallë, një fragment filmi apo një histori personale. Nxënësit i vëzhgojnë dhe diskutojnë në grupe se çfarë kanë të përbashkët këto forma komunikimi dhe pse njerëzit ndiejnë nevojën të rrëfejnë.

Në vijim, nxënësit analizojnë qëllimet e rrëfimit dhe identifikojnë funksione të ndryshme të tij, si:

- përcjellja e informacionit;
- shprehja e emocioneve dhe e përvojave personale;
- ruajtja e kujtimeve dhe e traditave;
- dhënia e këshillave ose e mesazheve;
- argëtimi dhe lidhja me të tjerët.



Secili grup paraqet përfundimet e veta përmes shembujve konkretë nga përvoja personale, librat, filmat etj. Gjatë diskutimit, mësuesi i udhëzon nxënësit të kuptojnë se rrëfimi është pjesë e komunikimit të përditshëm dhe përdoret në shumë forma dhe situata.

Në fund, klasa ndërton në tabelë një hartë koncepti me funksionet e rrëfimit, duke lidhur shembujt konkretë me rolin që luan rrëfimi në jetën personale, familjare etj.

2) *"Rrëfimi në jetën tonë"*

Nxënësit ndahen në grupe dhe analizojnë situata të ndryshme të jetës së përditshme ku përdoret rrëfimi, si: bisedat familjare, tregimet e shokëve, lajmet, komentet sportive, filmat ose përvojat personale që tregohen në klasë. Secili grup zgjedh disa shembuj konkretë dhe diskuton:

- kush po rrëfen;
- çfarë synon të përcjellë;
- si ndikon historia te dëgjuesi ose shikuesi.

Në vijim, grupet paraqesin shembujt e tyre përpara klasës dhe shpjegojnë pse edhe situatat më të zakonshme të komunikimit përmbajnë elemente rrëfimi. Gjatë diskutimit, nxënësit kuptojnë

se rrëfimi përdoret vazhdimisht për të shpjeguar ngjarje, për të ndarë përvoja, për të bindur, për të argëtuar ose për të krijuar emocione.

3) *"Nga përralla te podcasti"*

Klasa ndahet në grupe. Një grup analizon një përrallë ose legjendë shqiptare, ndërsa grupi tjetër dëgjon dhe analizon një podcast modern me karakter rrëfimtar. Nxënësit vëzhgojnë mënyrën si ndërtohet historia, si paraqiten personazhet, si përdoret gjuha dhe si mbahet vëmendja e dëgjuesit.

Në vijim, grupet krahasojnë rrëfimin tradicional me atë modern, duke identifikuar:

- elementet që kanë të përbashkëta;
- mënyrën si ndryshon forma e tregimit;
- ndryshimet në gjuhë, stil dhe mjete shprehëse;
- rolin e teknologjisë në rrëfimin modern.

Për organizimin e ideve, nxënësit plotësojnë një Diagram të Venit, ku:

- në njërën anë vendosen veçoritë e përrallës ose të legjendës;
- në anën tjetër veçoritë e podcastit;
- në pjesën e përbashkët shkruhen elementet që i bashkojnë të dyja format e rrëfimit.

Në fund, grupet prezantojnë diagramet e tyre dhe diskutojnë si rrëfimi ka ndryshuar me kalimin e kohës, por vazhdon të ketë të njëjtin funksion: të komunikojë përvoja, ide dhe emocione.

4) *"Historia që kalon brez pas brezi"*

Nxënësit intervistojnë një familjar për një histori ose kujtim që është treguar shpesh në familje. Në klasë, ata tregojnë si është ruajtur kjo histori dhe pse vazhdon të përcillet. Më pas diskutohet roli i rrëfimit në ruajtjen e kujtesës dhe të identitetit.

5) *"Kush po e tregon?"*

Nxënësit dëgjojnë fragmente të shkurtra nga tregime, podcaste, lajme ose filma dhe përpiqen të identifikojnë kush është rrëfimtari dhe çfarë marrëdhënie krijon ai me dëgjuesin. Diskutohet rëndësia e rrëfimtarit dhe e mënyrës së tregimit.

6) *"Rrëfimi që bind"*

Nxënësit analizojnë reklama, video motivuese ose postime që përdorin rrëfime personale për të bindur publikun. Ata identifikojnë elementet që i bëjnë këto rrëfime të besueshme dhe me ndikim.

7) *"Rrëfimi pa fund"*

Mësuesi lexon ose tregon një histori deri pranë përfundimit, por ndalon në momentin më të rëndësishëm të ngjarjes. Nxënësit, në mënyrë individuale ose në grupe, imagjinojnë dhe krijojnë fundin e saj.

Secili grup paraqet versionin e vet, duke shpjeguar:

- pse zgjodhi atë përfundim;
- si lidhet fundi me ngjarjet e mëparshme;
- çfarë mesazhi përcjell historia me atë mbyllje.

Në fund, klasa diskuton si ndryshon kuptimi, emocioni dhe mesazhi i një historie kur ndryshon përfundimi i saj.

TEMATIKA 2: STRUKTURA DHE ELEMENTET E RRËFIMIT

1) *"Historia e copëtuar"*

Mësuesi përzgjedh një tregim të shkurtër dhe e ndan në disa pjesë ose paragrafë, të cilët shpërndahen në mënyrë të çrregullt te grupet. Nxënësit lexojnë me kujdes secilën pjesë dhe bashkëpunojnë për të rindërtuar historinë në rendin e duhur. Ata analizojnë lidhjet mes ngjarjeve, kohën, personazhet dhe elementet gjuhësore që tregojnë vijueshmërinë e tregimit (p.sh. "më pas", "atëherë", "papritur").

Pasi grupet përfundojnë renditjen, secili grup prezanton versionin e vet dhe argumenton zgjedhjet që ka bërë. Në fund, klasa diskuton se si ndryshon kuptimi i historisë kur ngjarjet vendosen në rend të gabuar dhe pse struktura është e rëndësishme për qartësinë e rrëfimit.

2) *"Kush? Ku? Kur? Çfarë? Si?"*

Nxënësit dëgjojnë ose lexojnë një rrëfim të shkurtër dhe më pas plotësojnë një organizues grafik me pyetjet:

- Kush janë personazhet?
- Ku zhvillohen ngjarjet?
- Kur ndodhin ngjarjet?
- Cili është problemi ose konflikti?
- Si zgjidhet ai?

Në vijim, nxënësit punojnë në çifte dhe krijojnë një rrëfim të shkurtër duke përdorur të njëjtën skemë organizimi. Në fund, tregimet lexohen në klasë dhe nxënësit identifikojnë elementet kryesore të secilit rrëfim.

3) *"Piramida e rrëfimit"*



Mësuesi paraqet modelin e strukturë narrative (hyrja, zhvillimi, kulmi, zgjidhja dhe përfundimi). Në grupe, nxënësit zgjedhin një përrallë, tregim ose roman dhe plotësojnë strukturën duke vendosur ngjarjet kryesore në secilën pjesë.

Më pas, grupet prezantojnë punën e tyre dhe diskutojnë:

- si ndërtohet tensioni;
- cili është momenti më i rëndësishëm;
- si ndikon përfundimi në mesazhin e tregimit.

Në fund, nxënësit krijojnë individualisht një mini-strukturë për një histori personale.



4) *"Personazhi në qendër"*

Çdo grup zgjedh një personazh nga një tregim ose film dhe krijon një "profil personazhi". Në një fletë pune, nxënësit përshkruajnë:

- pamjen dhe tiparet fizike;
- emocionet dhe mendimet;
- dëshirat dhe qëllimet;
- marrëdhëniet me personazhet e tjerë;
- rolin e tij në zhvillimin e ngjarjeve.

Më pas, një nxënës "futet në rol" dhe përgjigjet si personazhi ndaj pyetjeve të klasës. Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë se personazhet janë element kyç në ndërtimin e rrëfimit.

5) *"Konflikti që lëviz historinë"*

Mësuesi paraqet situata të ndryshme problemore ose fragmente nga tekste rrëfyese ku shfaqet një konflikt. Në grupe, nxënësit identifikojnë:

- cili është problemi kryesor;
- kush përfshihet në konflikt;
- si ndikon konflikti në zhvillimin e historisë.

Në vijim, grupet krijojnë vazhdime të ndryshme për historinë, duke propozuar mënyra të ndryshme për zgjidhjen e konfliktit. Në fund, diskutohet pse konfliktet e bëjnë një rrëfim më interesant dhe si ndikojnë në emocionet e lexuesit ose të dëgjuesit.

6) *"Rrëfimi me fotografi"*

Mësuesi shpërndan fotografi ose imazhe të ndryshme (vende, njerëz, objekte, situata). Në grupe, nxënësit duhet të krijojnë një rrëfim duke lidhur logjikisht fotografitë me njëra-tjetrën. Ata përcaktojnë:

- fillimin e historisë;
- zhvillimin e ngjarjeve;
- kulmin;
- përfundimin.

Në fund, çdo grup prezanton tekstin e vet dhe shpjegon pse i organizoi fotografitë në atë mënyrë.

7) *"Nga fillimi në fund"*

Nxënësit lexojnë një tregim që ndalet në momentin para kulmit. Në grupe, ata diskutojnë dhe parashikojnë çfarë mund të ndodhë më pas. Secili grup shkruan vazhdimin e vet duke ruajtur logjikën e historisë dhe karakteristikat e personazheve.

Në fund, grupet lexojnë versionet e tyre dhe krahasojnë mënyrat e ndryshme si mund të zhvillohet i njëjta tekst. Mësuesi i udhëzon të reflektojnë mbi mënyrën si ndërtohet pritja dhe tensioni në rrëfim.

8) *"Ndrysho strukturën"*

Mësuesi paraqet një tregim të shkruar në rend kronologjik. Nxënësit punojnë në grupe për ta riorganizuar atë duke përdorur kthim pas në kohë (flashback). Ata vendosin:

- në cilin moment ngjarjet do të kthehen pas në kohë;
- çfarë informacioni do të zbulohet;
- si ndikon kjo në interesin e dëgjuesit ose lexuesit.

Në fund, grupet lexojnë të dyja versionet dhe diskutojnë cili variant është më tërheqës dhe pse.

9) *"Lojë me karta narrative"*

Mësuesi përgatit karta me kategori të ndryshme narrative, si:

- personazhe;
- vende;
- ngjarje;
- konflikte;
- objekte;
- emocione.

Nxënësit punojnë në grupe dhe tërheqin rastësisht nga një kartë për secilën kategori. Duke përdorur elementet e përzgjedhura, secili grup krijon skicën e një rrëfimi me fillim, zhvillim dhe përfundim. Gjatë punës, nxënësit diskutojnë:

- si lidhen elementet mes tyre;
- cili mund të jetë konflikti kryesor;
- si mund të zhvillohet historia në mënyrë logjike dhe interesante.

Më pas, grupet prezantojnë ë e tyre përpara klasës. Nxënësit e tjerë bëjnë pyetje ose japin ide për vazhdimin dhe përmirësimin e rrëfimit.

Veprimtaria zhvillon imagjinatën, organizimin e ideve dhe aftësinë për të ndërtuar struktura narrative në mënyrë krijuese dhe bashkëpunuese.

10) *"Një tregim, shumë mbyllje"*

Mësuesi u jep të gjitha grupeve të njëjtin fillim tregim dhe të njëjtin konflikt. Çdo grup krijon një mbyllje të ndryshme:

- një fund të lumtur;
- një fund të trishtuar;
- një fund të papritur;
- një fund të hapur.

Pas prezantimeve, klasa diskuton si ndryshon kuptimi dhe mesazhi i tregimit në varësi të mbylljes dhe cili version krijon më shumë emocion ose reflektim.

TEMATIKA 3: GJUHA DHE STILI I RRËFIMIT

1) *"Nga fjalia në fjali"*

Mësuesi shkruan në tabelë fjali të thjeshta, si: *"Djali hyri në klasë."*. Në grupe, nxënësit i pasurojnë këto fjali duke shtuar mbiemra, emra, folje ose ndajfolje. Për shembull: *"Djali i vogël hyri me ndrojtje në klasën e zhurmshme."*

Në fund, grupet lexojnë versionet e tyre dhe diskutojnë:

- cilat fjalë e bëjnë tregimin më të gjallë;
- si ndikon gjuha në imagjinatën e dëgjuesit ose lexuesit.

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë rolin e gjuhës në rrëfim.

2) *"Gjuha e emocioneve"*

Mësuesi paraqet emocione të ndryshme (frikë, gëzim, turp, zemërim, habi). Nxënësit punojnë në çifte dhe shkruajnë fragmente të shkurtra tregimtare ku emocioni nuk thuhet drejtpërdrejt, por kuptohet përmes veprimeve, mimikës dhe përshkrimeve.

P.sh., në vend të fjalisë *"Ai ishte i frikësuar"*, nxënësit shkruajnë: *"Duart i dridheshin dhe mezi arrinte të fliste."*

Në fund, fragmentet lexohen në klasë dhe nxënësit përpiqen të identifikojnë emocionin që paraqitet. Diskutohet si detajet dhe përshkrimet e bëjnë rrëfimin më shprehës dhe më realist.

3) *"Dialogu që i jep jetë rrëfimit"*

Nxënësit lexojnë një fragment pa dialog dhe më pas e rishkruajnë duke shtuar biseda mes personazheve. Ata punojnë në grupe për të krijuar dialogë që tregojnë emocionet, marrëdhëniet dhe konfliktet mes personazheve.

Pas shkrimit, grupet dramatizojnë dialogët përpara klasës. Më pas diskutohet:

- si dialogu e bën tregimin më të gjallë;

- si ndryshon ritmi i historisë;
- si ndihmon dialogu në kuptimin e personazheve.

4) *"Fjalët që krijojnë atmosferë"*

Mësuesi paraqet fotografi ose imazhe të ndryshme (*stuhi, pyll, qytet, det, stadium*). Në grupe, nxënësit krijojnë lista me fjalë dhe shprehje që lidhen me secilin mjedis. Më pas, ata shkruajnë një paragraf të shkurtër duke përdorur sa më shumë nga këto fjalë për të krijuar atmosferë. Në fund, klasa diskuton:

- si ndikon zgjedhja e fjalëve në përjetimin e historisë;
- cili përshkrim ishte më i gjallë dhe pse.

5) *"Rrëfimi në vetën e parë dhe të tretë"*

Nxënësit lexojnë një fragment në vetën e parë dhe më pas e rishkruajnë në vetën e tretë. Në grupe, ata krahasojnë:

- si ndryshon këndvështrimi;
- cili version duket më personal;
- si ndikon veta e rrëfimit në mënyrën si kuptohet historia.

6) *"Stili që të dallon"*

Nxënësit lexojnë fragmente të shkurtra nga autorë ose tregimtarë të ndryshëm dhe identifikojnë elemente të stilit të tyre:

- gjuhën;
- ritmin;
- humorin;
- përshkrimet;
- emocionet.

Më pas, secili nxënës shkruan një mini-rrëfim duke u përpjekur të krijojë një stil personal të të shkruarit. Në fund, klasës i lexohet pa emër secili tekst dhe nxënësit përpiqen të dallojnë çfarë e bën secilin stil të veçantë.

TEMATIKA 4: TEKNIKA TË RRËFIMIT

1) *"Hyrja që tërheq vëmendjen"*

Mësuesi paraqet hyrje të ndryshme tregimesh: një fillim me dialog, një me pyetje, një me veprim të menjëhershëm dhe një me përshkrim. Nxënësit diskutojnë cila hyrje i bën më

kureshtarë dhe pse. Në vijim, në grupe, nxënësit krijojnë mënyra të ndryshme për të nisur të njëjtën tregim. Secili grup lexon versionet e veta dhe klasa diskuton:

- cili fillim krijon më shumë interes;
- cili krijon më shumë emocion ose tension;
- si ndikon fillimi në pritshmërinë e lexuesit ose dëgjuesit.

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e hyrjes në rrëfim.

2) *"Rrëfimi me kthim pas në kohë"*

Mësuesi shpjegon teknikën e flashback-ut përmes shembujve nga filma, tregime ose romane të njohura. Më pas, nxënësit lexojnë një tekst të shkurtër dhe identifikojnë momentet ku rrëfimi kthehet pas në kohë.

Në vijim, nxënësit punojnë në çift dhe krijojnë një mini-rrëfim, ku:

- teksti nis nga një moment i rëndësishëm;
- më pas kthehet pas në kohë për të treguar çfarë ka ndodhur më parë;
- në fund rikthehet në kohën kryesore të ngjarjes.

Në fund, nxënësit lexojnë tregimet dhe diskutojnë si flashback-u e bën tekstin më interesant dhe më shprehës.

3) *"Ndërto një tension!"*

Mësuesi paraqet një situatë të thjeshtë tregimtare, p.sh.: *"Një nxënës dëgjon një zhurmë të çuditshme në shkollë kur të gjithë janë larguar."*

Në grupe, nxënësit zhvillojnë historinë duke shtuar elemente që rrisin tensionin:

- përshkrime;
- heshtje;
- detaje misterioze;
- reagime të personazhit.

Më pas, grupet lexojnë versionet e tyre dhe klasa diskuton:

- cili moment krijoi më shumë tension;
- cilat fjalë ose detaje e bënë tekstin më emocionues.

4) *"Ritmi"*

Nxënësit lexojnë dy fragmente: një me fjali të gjata dhe përshkrime të shumta dhe një tjetër me fjali të shkurtra dhe veprime të shpejta. Ata analizojnë si ndryshon ritmi i rrëfimit dhe si ndikon ai në emocionin e historisë. Në vijim, nxënësit rishkruajnë një skenë duke ndryshuar ritmin:

- për ta bërë më të qetë;

- ose më dinamike dhe me tension.

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë si struktura e fjalive ndikon në mënyrën si përjetohet rrëfimi.

5) *"Trego, mos e thuaj"*

Mësuesi shkruan në tabelë fjali si:

"Ajo ishte e lumtur."

"Ai ishte nervoz."

Nxënësit punojnë në grupe dhe i kthejnë këto fjali në përshkrime tregimtare pa përmendur drejtpërdrejt emocionin. Për shembull: *"Ajo nuk pushonte së buzëqeshuri dhe kërcente nëpër dhomë."*

Në fund, grupet lexojnë shembujt e tyre dhe klasa diskuton si veprimet dhe detajet e bëjnë rrëfimin më të fuqishëm dhe më realist.

6) *"Rrëfimi nga një këndvështrim tjetër"*

Nxënësit zgjedhin një tekst të njohur dhe e ritregojnë nga këndvështrimi i një personazhi tjetër ose edhe nga këndvështrimi i një objekti.

P.sh.: Kësulëkuqja" nga këndvështrimi i ujkut.

Në fund, diskutohet:

- si ndryshon teksti kur ndryshon këndvështrimi;
- si ndikojnë këndvështrimet në mënyrën si kuptohen ngjarjet dhe personazhet.

TEMATIKA 5: RRËFIMI DHE TEKNOLOGJIA DIGJITALE

1) *"Nga tregimi te podcast-i"*

Nxënësit punojnë në grupe dhe zgjedhin një histori personale, një intervistë të shkurtër ose një ngjarje nga jeta e përditshme që do ta paraqesin në formë podcasti. Fillimisht, ata dëgjojnë shembuj të shkurtër podcastesh tregimtare dhe diskutojnë si ndryshon përjetimi i një historie kur ajo dëgjohet dhe nuk lexohet.

Në vijim, grupet organizojnë punën:

- duke përzgjedhur temën ose rrëfimin;
- duke ndarë rolet (intervistuesi, i intervistuari, efektet zanore);
- duke përshtatur tekstin për format audio;
- duke ushtruar mënyrën e të folurit, intonacionin dhe ritmin e rrëfimit.

Më pas, nxënësit regjistrojnë podcastin duke përdorur mjete të thjeshta digjitale. Ata mund të shtojnë muzikë për të krijuar atmosferë dhe për ta bërë rrëfimin më tërheqës.

Në fund, podcastet dëgjohen në klasë dhe nxënësit diskutojnë:

- si ndikojnë zëri dhe intonacioni në mënyrën si kuptohet historia;
- si krijohet emocioni vetëm përmes tingullit;
- cilat elemente e bënë podcastin më interesant dhe më të qartë për dëgjuesin.

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë si mund të përdoret teknologjia për të krijuar forma moderne të rrëfimit.

2) *"Rrëfimi me fotografi"*

Nxënësit krijojnë një histori duke përdorur fotografi personale, ilustrime ose imazhe të përzgjedhura. Ata organizojnë fotografitë sipas rrjedhës së ngjarjeve dhe shtojnë tituj, përshkrime ose fragmente të shkurtra tregimtare.

Në vijim, secili nxënës ose grup prezanton rrëfimin e vet në formë prezantimi digjital. Klasa diskuton:

- si ndihmojnë imazhet në kuptimin e historisë;
- cilat fotografi krijojnë më shumë emocion;
- si lidhen pamjet me rrjedhën narrative.

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë lidhjen mes elementeve pamore dhe rrëfimit.

3) *"Video-rrëfimi"*

Në grupe, nxënësit krijojnë një video të shkurtër tregimtare duke kombinuar:

- zërin;
- figurën;
- muzikën;
- tekstin.

Ata planifikojnë strukturën, ndajnë rolet dhe realizojnë xhirimet ose montazhin me mjete të thjeshta digjitale.

Në fund, videot prezantohen në klasë dhe nxënësit diskutojnë:

- si ndryshon rrëfimi kur kombinohen imazhi dhe zëri;
- si ndikojnë efektet pamore dhe muzika në emocionin e historisë;
- cilat elemente e bëjnë videon më të qartë dhe më tërheqëse.

4) *"Rrëfimi digjital me Canva"*

Nxënësit krijojnë një tregim digjital në Canva ose platforma të ngjashme, duke përdorur:

- ilustrime;

- ngjyra;
- animacione;
- tekst të shkurtër;
- audio ose video.

Gjatë punës, ata përqendrohen jo vetëm te historia, por edhe te mënyra si paraqitet ajo vizualisht. Në fund, nxënësit prezantojnë tregimet dhe reflektojnë:

- si ndikon dizajni në kuptimin e historisë;
- si mund të përdoret teknologjia për ta bërë rrëfimin më interesant dhe më të qartë.

5) *"Një rrëfim në një minutë"*

Nxënësit krijojnë një video ose audio shumë të shkurtër (maksimumi 1 minutë), ku duhet të tregojnë një histori të plotë me:

- hyrje;
- zhvillim;
- pikë kulminante;
- përfundim.

Veprimtaria i ndihmon ata të kuptojnë rëndësinë e përzgjedhjes së informacionit dhe të organizimit të ideve në mënyrë të përmbledhur. Në fund, klasa voton ë që arritën të përcjellin më qartë emocionin dhe mesazhin në kohë të shkurtër.

6) *"Rrëfimi ndërveprues"*

Nxënësit punojnë në grupe dhe krijojnë një histori ku audienca mund të zgjedhë si do të vazhdojë rrëfimi. Historia ndërtohet me disa mundësi zgjedhjeje, p.sh.:

- Nëse personazhi hap derën, kalo te pjesa 2.
- Nëse largohet, kalo te pjesa 3."

Për realizimin e veprimtarisë, nxënësit përdorin platforma të thjeshta, ku secila zgjedhje çon te një vazhdim tjetër i historisë. Në këtë mënyrë, e njëjta histori mund të ketë mbyllje ose zhvillime të ndryshme.

Gjatë punës, grupet:

- ndërtojnë personazhet dhe ngjarjen kryesore;
- vendosin momentet ku historia ndahet në drejtime të ndryshme;
- krijojnë përfundime të ndryshme për rrëfimin;
- organizojnë lidhjet mes pjesëve të historisë.

Në fund, grupet prezantojnë tregimet e tyre dhe klasa zgjedh rrugë të ndryshme të historisë për të parë si ndryshon rrëfimi në varësi të zgjedhjeve.

Më pas, nxënësit diskutojnë:

- si ndryshon kuptimi ose përfundimi i historisë;
- cili version ishte më interesant dhe pse;
- si teknologjia mund ta bëjë rrëfimin më ndërveprues dhe më kreativ.

7) *"Teknologjia dhe etika e rrëfimit"*

Mësuesi hap një diskutim mbi përdorimin e përgjegjshëm të teknologjisë gjatë krijimit të rrëfimeve digjitale. Nxënësit analizojnë situata konkrete:

- përdorimin e fotografive pa leje;
- publikimin e historive personale të të tjerëve;
- respektimin e autorësisë dhe të burimeve.

Në fund, grupet hartojnë një listë rregullash për përdorimin etik dhe të sigurt të teknologjisë në krijimin dhe shpërndarjen e rrëfimeve.

TEMATIKA 6: DËGJIMI AKTIV DHE EMPATIA NË RRËFIM

1) "Dëgjo dhe ritrego"

Nxënësit punojnë në çifte. Njëri nxënës tregon një histori të shkurtër personale ose imagjinare, ndërsa tjetri dëgjon pa e ndërprerë. Pas përfundimit, dëgjuesi duhet ta ritregojë historinë me fjalët e veta, duke ruajtur sa më saktë ngjarjet dhe emocionet e rrëfimtarit.

Në fund, nxënësit diskutojnë:

- sa e vështirë është të dëgjosh me vëmendje;
- cilat detaje mbahen mend më lehtë;
- si ndihet një person kur dëgjohet me vëmendje dhe respekt.

Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e dëgjimit aktiv në komunikim.

2) "Pyetja që tregon interes"

Mësuesi paraqet një histori të shkurtër ose një situatë personale. Në grupe, nxënësit i drejtojnë pyetje që tregojnë interes, ndjeshmëri dhe dëgjim aktiv, si:

- Si u ndjetë në atë moment?
- Çfarë menduar kur ndodhi kjo?
- Si do të vepronit ndryshe?

Më pas, nxënësit praktikojnë intervista të shkurtra me njëri-tjetrin duke përdorur pyetje të hapura dhe gjuhë të kujdesshme. Diskutohet si pyetjet mund ta ndihmojnë rrëfimtarin të shprehet më lirshëm dhe më qartë.

3) "Në vendin e personazhit"

Nxënësit lexojnë ose dëgjojnë një tregim ose fragment romani ku personazhi përjeton një situatë të vështirë. Në vijim, secili nxënës shkruan ose tregon:

- si do të ndihej në vend të personazhit;
- çfarë do të mendonte;
- si do të vepronte në atë situatë.

Në fund, klasa diskuton si rrëfimet i ndihmojnë njerëzit të kuptojnë më mirë ndjenjat dhe këndvështrimet e të tjerëve.

4) "Rrëfimi me emocione"

Mësuesi përgatit karta me emocione të ndryshme (gëzim, frikë, habi, trishtim, krenari). Nxënësit zgjedhin një kartë dhe tregojnë një histori të shkurtër ku ai emocion është i pranishëm. Ndërsa dëgjojnë, nxënësit e tjerë përpiqen të identifikojnë emocionin dhe të shpjegojnë cilat pjesë të rrëfimit i ndihmuan ta kuptonin atë. Veprimtaria ndihmon në zhvillimin e ndjeshmërisë dhe të kuptimit emocional përmes rrëfimit.

5) "Rrethi i rrëfimit"

Nxënësit ulen në rreth dhe secili ka mundësi të tregojë një përvojë, kujtim ose mendim të shkurtër. Rregulli kryesor është që askush të mos ndërpresë rrëfimtarin dhe çdo nxënës të tregojë respekt për atë që dëgjon.

Pas çdo rrëfimi, nxënësit mund të bëjnë komente ose pyetje pozitive dhe mbështetëse. Në fund, klasa reflekton:

- si ndryshon komunikimi kur njerëzit dëgjojnë me kujdes;
- si ndikon respekti në mënyrën si tregojmë historitë tona.

6) "Historia nga një këndvështrim tjetër"

Nxënësit dëgjojnë një histori me konflikt mes personazheve. Më pas, në grupe, ata e ritregojnë ngjarjen nga këndvështrimi i një personazhi tjetër.

Në fund, grupet prezantojnë versionet e tyre dhe diskutojnë:

- si ndryshon kuptimi i historisë kur ndryshon këndvështrimi;
- pse është e rëndësishme të kuptojmë perspektivat e të tjerëve.

Veprimtaria zhvillon empatinë dhe aftësinë për të parë situatat nga këndvështrime të ndryshme.

7) "Komenti që ndihmon"

Pas leximit ose prezantimit të një historie, nxënësit japin vlerësime për njëri-tjetrin duke përdorur komente të kujdesshme.

Mësuesi i udhëzon të përdorin shprehje si:

- Më pëlqeu mënyra si…
- Mund të shtoje më shumë…
- E kuptova emocionin kur…

Në fund, klasa diskuton:

- pse vlerësimi duhet të jetë mbështetës;
- si komentet ndihmojnë në përmirësimin e rrëfimit dhe komunikimit.

8) "Tregimi në heshtje"

Një nxënës tregon një histori të shkurtër, ndërsa të tjerët nuk flasin, por tregojnë vëmendje përmes komunikimit joverbale:

- kontaktit me sy;
- mimikës;
- tundjes së kokës;
- reagimeve emocionale.

Pas përfundimit, rrëfimtari shpjegon si u ndie gjatë tregimit dhe cilat reagime e ndihmuan të vazhdonte më me siguri. Veprimtaria ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë e komunikimit joverbal në dëgjimin aktiv.

TEMATIKA 7: KRIJIMI DHE PREZANTIMI I RRËFIMEVE

1) *"Nga ideja te rrëfimi"*

Nxënësit zgjedhin një temë për rrëfimin e tyre final. Tema mund të lidhet me:

- një përvojë personale;
- një kujtim të rëndësishëm;
- një histori familjare;
- një ngjarje imagjinare;
- një situatë nga jeta e përditshme.

Fillimisht, ata plotësojnë një fletë planifikimi ku përcaktojnë:

- personazhet;
- vendin dhe kohën;

- konfliktin ose ngjarjen kryesore;
- mënyrën si do të përfundojë teksti;
- mesazhin që duan të përcjellin.

Në fund, nxënësit prezantojnë idenë e tyre në klasë dhe marrin sugjerime nga bashkëmoshatarët dhe mësuesi për zhvillimin e mëtejshëm të rrëfimit.

2) *"Punë për rrëfimin"*

Nxënësit punojnë individualisht ose në çifte për të shkruar dhe zhvilluar rrëfimin e tyre. Gjatë punës, mësuesi organizon "stacione ndihmëse", ku nxënësit mund të marrin mbështetje për:

- strukturën;
- përdorimin e gjuhës dhe të përshkrimeve;
- ndërtimin e dialogut;
- organizimin e ngjarjeve;
- përmirësimin e fillimit ose përfundimit.

Në vijim, nxënësit shkëmbejnë tregimet me njëri-tjetrin dhe japin komente për përmirësimin e tyre.

3) *"Rrëfimi që bëhet zë"*

Nxënësit përzgjedhin një pjesë nga rrëfimi i tyre dhe e lexojnë ose e tregojnë me zë përpara klasës. Gjatë prezantimit, ata përqendrohen te:

- intonacioni;
- ritmi i të folurit;
- shprehja e emocioneve;
- kontakti me dëgjuesin.

Më pas, klasa diskuton:

- cili moment ishte më emocionues;
- si ndikoi mënyra e tregimit në përjetimin e historisë;
- çfarë mund të përmirësohet në prezantim.

4) *"Rrëfimi në formë digjitale"*

Nxënësit zgjedhin një mënyrë digjitale për ta paraqitur historinë e tyre:

- podcast;
- video;
- prezantim me fotografi;
- etj.

Ata organizojnë materialet, zgjedhin imazhet, muzikën ose efektet zanore dhe krijojnë versionin final të rrëfimit të tyre. Gjatë punës, mësuesi i udhëzon të ruajnë qartësinë e rrëfimit dhe lidhjen mes elementeve vizuale dhe tekstit.

5) *"Festivali i rrëfimeve"*

Në përfundim të modulit, organizohet një aktivitet prezantues në klasë ose në shkollë, ku nxënësit paraqesin rrëfimet e tyre përpara një audience.

Prezantohet:

- leximi ose tregimi gojor i historisë;
- podcasti ose videoja;
- posteri ose forma digjitale e rrëfimit.

Gjatë prezantimeve, nxënësit e tjerë mbajnë shënime mbi:

- strukturën e rrëfimit;
- përdorimin e gjuhës;
- emocionin dhe mesazhin;
- mënyrën e prezantimit.

Në fund, zhvillohet një diskutim i përbashkët mbi përvojën e krijimit dhe të tregimit të historive.

6) *"Reflektoj mbi rrëfimin tim"*

Në fund të modulit, nxënësit plotësojnë një fletë reflektimi ku analizojnë:

- çfarë kanë mësuar gjatë modulit;
- cilat aftësi kanë përmirësuar;
- çfarë ishte më e lehtë ose më e vështirë;
- si ndryshoi mënyra e tyre e të treguarit.

Ata vendosin edhe synime personale për mënyrën si mund të përdorin rrëfimin në komunikimin e tyre të përditshëm.

PRODUKTI FINAL

Në përfundim të modulit, çdo nxënës krijon dhe prezanton një rrëfim në formë gojore, të shkruar ose digjitale, duke zbatuar njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë modulit.

Rrëfimi mund të jetë:

- personal;
- imagjinar;
- i bazuar në një përvojë familjare ose shoqërore.

Produkti final duhet të përfshijë:

- strukturë të qartë narrative;
- përdorim të gjuhës shprehëse;
- elemente përshkruese dhe dialog;
- prezantim të qartë dhe të organizuar.

Produkti final shërben si dëshmi konkrete e zhvillimit të aftësive të nxënësve në krijimin, organizimin dhe prezantimin e rrëfimeve.

9. SHPËRNDARJA SUGJERUESE E ORËVE SIPAS TEMATIKAVE

Ndarja e orëve sipas tematikave është sugjeruese dhe mund të përshtatet nga mësuesi në varësi të nevojave të klasës dhe ritmit të të nxënit. E rëndësishme është që të respektohet totali i përgjithshëm prej 35 orësh për zhvillimin e modulit.

Nr.	Tematikat	Orë
1	Rrëfimi dhe rëndësia e tij	4 orë
2	Struktura dhe elementet e rrëfimit	6 orë
3	Gjuha dhe stili i rrëfimit	6 orë
4	Teknika të rrëfimit	5 orë
5	Rrëfimi dhe teknologjia digjitale	4 orë
6	Dëgjimi aktiv dhe empatia në rrëfim	3 orë
7	Krijimi dhe prezantimi i rrëfimeve	7 orë
TOTALI		**35 orë**

10. BIBLIOGRAFIA

- Curriculument.com. *Storytelling Activities and Narrative Techniques for Middle School Students*.
- Egan, Kieran. *Teaching as Story Telling*. University of Chicago Press.
- Haven, Kendall. *Story Proof: The Science Behind the Startling Power of Story*. Libraries Unlimited.
- Lambert, Joe. *Digital Storytelling: Capturing Lives, Creating Community*. Routledge.
- National Storytelling Network. *Resources for Storytelling in Education*.
- Robin, Bernard. *The Educational Uses of Digital Storytelling*. University of Houston.
- Zipes, Jack. *The Irresistible Fairy Tale: The Cultural and Social History of a Genre*. Princeton University Press.
- Ministria e Arsimit. *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*, 2024.
- Ministria e Arsimit: *Programet lëndore të gjuhës shqipe për arsimin e mesëm të ulët*, 2025.
- Tekste dhe përmbledhje me përralla, mite, legjenda dhe tregime nga folklori shqiptar dhe botëror, si dhe nga shkrimtarë të letërsisë shqipe dhe asaj botërore.
- Platforma dhe mjete digjitale për krijimin e rrëfimeve: Canva, Storybird, Storyboard That etj.